



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:119279 **C. nr. 843/2019**
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05523327

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.C. e mitur të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor babai i saj S.C. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.Sh. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ‘‘Illyria’’ me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e dëmit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 29 Mars 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses R.C. e mitur të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor babai i saj S.C. nga fshati Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve ‘‘Illyria’’ me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material dhe jo material për lëndimet e pësuar në aksidentin e komunikacionit t’ia kompensoi shumat si në vijim: në emër të dhembjeve fizike shumë prej 800 euro, për frik të përjetuar shumë prej 500 euro, për shëmtim shumë prej 500, për ndihmë dhe kujdes të huaj shumë prej 500 euro, për ushqim të përforcuar shumë prej 500 euro, për shërim klimaterik shumë prej 500 euro, për rroba të dëmtuara shumë prej 150 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, si kërkesa të pa bazuara.

A r s y e t i m

Paditësja R.C. e mitur të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor babai i saj S.C. nga fshati Komuna e Prizrenit, përmes përfaqësuesit të tyre, pranë kësaj gjykate me datën 03 Korrik 2019, ka parashtruar padi, me të cilën ka theksuar se më datë 21.03.2019, në rrugën magjistrale prej fshatit për në fshatin ka ndodhur fatkeqësi e komunikacioni i cili ka ardh si pasoj e pakujdesisë së vozitësit të veturës ‘‘A’’ – Bus, me targa të regjistrimit ku duke mos u siguruar paraprakisht mbi gjendjen teknike të automjetit përderisa ishte duke bërë transportin e fëmijëve, gjatë udhëtimit goma e automjetit i del jashtë dhe nga tronditjet në automjet lëndime trupore pëson udhëtarja, këtu e dëmtuara e mitur R.C. Automjeti i cili ka shkaktuar aksidentin ka pasur të kontraktuar policën e sigurimit në Kompaninë e Sigurimeve

“Illyria”, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të bjerëaktgjykim sipas kërkesave si n[en] I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 25.03.2024, i ka deklaruar gjykatës se heqë dorë nga kërkesëpadija, duke mos shprehur interes juridik në këtë çështje kontestimore me arsyetimin se lidhur me kontestin e lartcekur me të paditurën janë dakorduar me ofertë për kompensimin e dëmit material dhe jo material në procedurë administrative e që pas të njëjtës kanë arritur ujdë jashtëgjyqësore më datë 14.03.2024, të cilën ujdë ja ka bashkangjitur parashtrësës.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 149 dhe 388, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në pikën një të këtij dispozitivi të aktgjykimit.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave nga neni 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 843/2019, datë 29 Mars 2024

B.profesional
Irir Sërtollaj

Gjyqtari
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.